



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit
Mbledhja nr. 87

Prishtinë, më 22.12.2016, në orën 22:40

Ndërtesa e Kuvendit, salla –S 1

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Selville Halimi, Danush Ademi, Agim Aliu, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj, Agim Ademaj, Doruntinë Maloku, Pal Lekaj dhe Milena Miliçević.

Munguan: Albulena Haxhiu dhe Valdete Bajrami.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Sanije Berisha, OSBE dhe Argjend Zejmaj, GP/AAK

Mbledhjen e kryesoi, Selville Halimi, nënkryetare e Komisionit.

Nga Stafi Mbështetës: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017

Selvije Halimi, kryesuese, paraqiti për shqyrtim Raportin me amendamente të Komisionit Funkcional nr. 05/L-125 të Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje.

Armend Zemaj- Komisioni për legjislacion caktoi një grup punues për t'i trajtuar kërkesat e Institucioneve/Agjencive që bien në fushëveprim të Komisionit. Ne i kemi mbajtur dy takime dhe në takimin e dytë me deputetët Agim Aliu dhe Pal Lekaj kemi vendosur që të përkrahim tre nënkode buxhetore që kanë bëjnë; 2 (dy) me Ministrinë e Drejtësisë dhe 1 (një) me Këshillin Prokurorial të Kosovës. Një kërkesë për Ministrinë e Drejtësisë është fut në pjesën buxhetore me përkrahjen e Komisionit Funkcional, ndërsa kërkesa tjetër ku kërkohet kompensimi i Viktimave të Krimin, në implementimin e këtij ligji nuk ka gjetur përkrahje shtesë. Ndërsa, e dyta është përkrahja për Këshillin Prokurorial të Kosovës për Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit që t'i ofrohet mbështetje kabinetit të tij për tri pozita zyrtare dhe po ashtu për dy bashkëpunëtorë profesionalë, kërkesa këto që nuk kanë gjetur përkrahje. Këto kërkesa do t'i paraqes në seancë plenare ndërsa për pjesën tjetër nuk kam ndonjë vërejtje.

Agim Aliu- Do të ishte mirë që ne të ushtrojmë ndikimin në grupet tona Parlamentare që të kalojnë këto amendamente, të cilat ne i kemi konsideruar të rëndësishme dhe që nuk kanë ndonjë shumë të papërbalueshme për buxhetin.

Armend Zemaj- Propozoj që tek amendamenti 27, në shpenzimet e paparashikuara nënparagrafi 1.1 t'i fusim edhe këto kërkesat tona me shumë rreth 40 mijë euro për arsye se nuk ka kohë për të bërë amendament shtesë dhe kjo kërkesë të bëhet direkt në seancë. Ky propozim u përkrah njëzëri.

Meqë nuk pati më diskutime, kryesuesja konstatoi se Komisioni njëzëri vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

1. Projektligji nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017 dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

3. Të ndryshme

Për këtë pikë nuk pati asgjë për diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 23:05.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryesuesja e Komisionit,

Selvije Halimi